

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 27 TETOR 2022

Faleminderit, e nderuar drejtuese e komisionit!

Faleminderit edhe për prezantimin, sepse, sigurisht, ne nuk shkojmë sot në diskutime, por vlen të theksojmë edhe nga prezantimi i djeshëm, edhe nga i sotmi, se buxheti sjell në vëmendje dy elemente shumë të rëndësishme dhe pozitive: rritjen pozitive ekonomike dhe uljen e borxhit, të cilat, sigurisht, përtej detyrimit ligjor që e kemi për vitin 2023, vijnë në formë të reduktuar duke filluar nga ky vit. E për këtë janë dy elemente shumë të rëndësishme për t'i theksuar, por ajo që tërheq vëmendjen në kuadrin makro, kjo edhe në vijim të asaj që tha kolegu Braçe, është se të ardhurat totale jo vetëm për vitin që po diskutojmë 2023-in, mbeten 29% mbi PBB, por edhe në terma afatmesme nuk e kalojnë 30%-in.

Pra, duke parashikuar që të ardhurat ngelen përsëri poshtë nivelit 30% mbi PBB, nevoja për të diskutuar masat fiskale për vitin 2023 apo edhe të masave që lidhen me miradministrimin fiskal është shumë i rëndësishëm për këtë komision. Prandaj, pa dashur t'i përsëris, e kisha shumë të nevojshme ta thosha të gjithë pjesën e efektit që fiskalizimi apo ligje që lidhen me kontrole të tjera, si regjistrat e kontrolleve bankare të pronarëve përfitues e të tjera, ligje që janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, të kenë mundësi të projektojnë se çfarë pjese e të ardhurave nga miradministrimi fiskal si rezultat i këtyre referencave parashikohen për vitin që vjen, por edhe në afatmesëm.

Së dyti, ne kemi diskutuar edhe më parë që unifikimi i tarifave ul informalitetin dhe për këtë janë të mirëpritura si çështjet që lidhen me akcizat ashtu edhe me elemente të tjera, siç është ajo e profesioneve të lira. Ne e dimë shumë që prej vitesh janë gjetur hapësira në zbatimin e ligjit ku gati 2 miliardë, në mos gabo, kanë munguar çdo vit në buxhetin e shtetit si rezultat i kalimit të profesioneve të lira në një regjim tjetër, prandaj e mirëpresim këtë ndryshim. Përsëri lind pyetja: po korrigjime të tjera të përjashtimeve, të cilat janë diskutuar dhe janë sjellë edhe në diskutimin e strategjisë afatmesme për sektorë të tjerë që mund të kenë impakt në afatmesëm, a janë parashikuar dhe a do të vijnë?

Mund të mos jenë për 2023-in, por të paktën të kemi një projeksion se kur do të jenë, sidomos për sektorët që kanë peshë në të ardhura më të madhe sesa këto që ju thashë pak më parë. Ne kemi diskutime edhe nga viti i kaluar kur kemi folur për imputet bujqësore, këtë vit për akcizën, këto janë gjëra shumë të mira, por kemi edhe sektorë të tjerë ku korrigjimet për ato masa të përjashtimeve që nuk

kanë sjellë efektivitet mund të projektohen për ta kaluar këtë 29% të paktën pas 2 apo 3 vjetëve, por edhe në afatmesëm ky është, për mendimin tim, një shqetësim i madh që nuk reflektohet në kuadrin makro. Së fundi, personalisht e mirëpres luftën ndaj cash-it në ekonomi, kjo sigurisht jo vetëm në frymën e ligjit të fiskalizimit, të cilin e kemi punuar, por edhe në raport me nevojën për ta ulur cash-in në ekonomi. Ndërkohë, do të doja të sillja përsëri në vëmendje edhe betejën ndaj deurizimit, sepse edhe kjo është një çështje jo më pak e rëndësishme.

Është punuar me Bankën e Shqipërisë, është një marrëdhënie e kahershme e Ministrisë së Financave me Bankën e Shqipërisë, prandaj në këtë aspekt do të kisha një pyetje: a është në plan për ta luftuar deurizimin, duke eliminuar minimumi atë që rëndom shohim në çdo kontratë noteriale, heqjen e euros nga qarkullimi i çdo transaksioni në kontrata? Nëse ne flasim që cash-i në ekonomi duhet të ulet, gjithashtu duhet të ulet edhe përdorimi i monedhës së huaj për kontratat që bëhen në Republikën e Shqipërisë. Sigurisht, kjo nuk është një përpjekje vetëm e Ministrisë së Financave, por do të ishte e nevojshme që kjo nevojë e shtuar për ta adresuar, ndoshta jo këtë vit, por për ta pasur në afatmesëm, është një problem po aq i rëndësishëm. Pyetja që unë kam është: a ka një plan afatshkurtër edhe për betejën ndaj deurizimit? Faleminderit!